



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2026

**PËR**

**“PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME PËR USHTRIMIN E KOMPETENCAVE TË INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM, RREGULLAT PËR PËRMBAJTJEN, ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT ELEKTRONIK “E-INSPEKTIMI”, MËNYRËN E RAPORTIMIT, KËRKIMIT TË INFORMACIONIT, INSPEKTIMIT TË DOSJEVE DHE DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME, SI DHE MBIKËQYRJEN NË TERREN TË PROCEDURAVE TË INSPEKTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT**

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e procedurave të hollësishme për ushtrimin e kompetencave të Inspektoratit të Përgjithshëm, rregullat për përmbajtjen, administrimin e të dhënave të sistemit elektronik “e-Inspektimi”, mënyrën e raportimit, kërkimit të informacionit, inspektimit të dosjeve dhe dokumenteve të nevojshme, si dhe mbikëqyrjen në terren të procedurave të inspektimit.
2. Ky vendim është i zbatueshëm nga Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore, vendore, si dhe strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin, të përcaktuara sipas dispozitave në fuqi të ligjit për inspektimin.

## II. KOMPETENCAT E INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM PËR ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT ELEKTRONIK TË INSPEKTIMEVE “E-INSPEKTIMI”

1. Inspektorati i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

- a) miraton dhe aplikon rregullat, për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”;
- b) koordinon dhe monitoron veprimtaritë e inspektimit, nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”;
- c) administron dhe përdor sistemin unik “*e-Inspektimi*”, që shërben për kryerjen e veprimtarive inspektuese, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve qendrore dhe vendore, sipas rregullave të hollësishme të përcaktuara në këtë vendim.
- ç) mban dhe përditëson të gjitha të dhënat mbi ankesat, denoncimet e ardhura nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë, për veprimtaritë e inspektorateve dhe inspektorëve, si dhe procedurat e inspektimit;
- d) jep mendim këshillimor për programet vjetore të inspektimit të hartuara nga inspektoratet qendrore dhe miraton programet e tyre mujore të inspektimit. Për inspektoratet vendore, jep mendim këshillimor si për programet vjetore, ashtu edhe për programet mujore të inspektimit, në përputhje me parimet e bashkërendimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese në nivel kombëtar;
- dh) miraton çdo kërkesë nga inspektoratet qendrore dhe vendore, që lidhet me zbatimin, ndryshimin apo veprimet në sistemin elektronik unik “*e-Inspektimi*”;
- e) gjeneron dhe printon kartën e përkohshme të identifikimit të inspektorit në kohë prove, si dhe kartën e inspektorit në detyrë për inspektoratet qendrore, në përputhje me standardet e përcaktuara për identifikimin dhe autorizimin zyrtar të tyre;
- ë) mban dhe përditëson listat e inspektorëve në detyrë, të inspektorëve qendrore, vendorë dhe strukturave me funksione inspektuese;
- f) përcakton rregullat për realizimin e veprimtarisë inspektuese në raste të jashtëzakonshme, kur nuk është i mundur ushtrimi i veprimtarisë inspektuese në distancë (online) nëpërmjet sistemit elektronik të inspektimeve “*e-Inspektimi*”;
- g) mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore nga inspektorët, në lidhje me programimin, autorizimin dhe realizimin e procesit të inspektimit të inspektorateve qendrore, vendore dhe strukturave përgjegjëse për inspektimin, duke siguruar përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe standardet e inspektimit;
- gj) koordinon e mbikëqyr ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorateve vendore, për të siguruar zbatimin e kuadrit ligjor në mënyrë të unifikuar, si dhe për të parandaluar dhe shmangur mbivendosjet e kompetencave ndërmjet inspektorateve vendore dhe atyre qendrore, me qëllim garantimin e një veprimtarie inspektuese të harmonizuar dhe efektive në nivel kombëtar;
- h) mbikëqyr procedurat e ankimit kundër vendimit përfundimtar në fushën e inspektimit, si dhe merr pjesë në komisionin e shqyrtimit të ankimit pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, sa herë që kjo kërkohet nga autoriteti përkatës vendor, sipas përcaktimeve të ligjit për inspektimin;
- i) drejton dhe bashkërendon punën për grumbullim, përditësimin, dhe gjenerimin e të dhënave cilësore dhe sasiore, që lidhen me burimet dhe kapacitetet e sektorëve të inspektimit që mbulon, me qëllim sigurimin e një informacioni të plotë për programimin dhe zhvillimin e veprimtarisë inspektuese;
- j) kërkon informacion të nevojshëm në lidhje me veprimtarinë e inspektorateve qendrore e vendore

dhe çdo dokumentacion tjetër të lidhur me programimin dhe kryerjen e procedimit administrativ të inspektimit, si dhe inspekton dosjet e inspektimit, në funksion të mbikëqyrjes së ligjshmërisë dhe efektivitetit të veprimtarisë inspektuese;

k) ka të drejtë të mbikëqyrë në terren procedurat e inspektimit të zhvilluara nga inspektoratet, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me kuadrin ligjor dhe me standardet përkatëse të inspektimit;

l) gjeneron raporte, nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”, në modulën përkatës, mbi veprimtarinë e Inspektoratit të Përgjithshëm, inspektorateve qendrore, vendore dhe strukturave të tjera përgjegjëse për inspektimin, në funksion të mbikëqyrjes, transparencës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë inspektuese.

### III. PËRMBAJTJA, ADMINISTRIMI DHE FUNKSIONET E SISTEMIT UNIK ELEKTRONIK “E-INSPEKTIMI”

1. Me anë të këtij vendimi përcaktohet krijimi dhe funksionimi i bazës së të dhënave shtetërore të sistemit unik elektronik “e-Inspektimi”, në vijim (sistemi “e-Inspektimi”).

2. Inspektorati i Përgjithshëm është institucioni përgjegjës për administrimin e sistemit “e-Inspektimi”.

3. Veprimtaria e inspektimit, që kryhet nga inspektoratet qendrore, vendore dhe strukturat përgjegjëse për inspektimin, sipas ligjit të inspektimit, dokumentohet e administrohet nëpërmjet sistemit elektronik “e-Inspektimi” dhe është i detyrueshëm për të gjitha inspektoratet qendrore, vendore, dhe strukturat përgjegjëse për inspektimin.

4. Procedura administrative e inspektimit realizohet nëpërmjet sistemit elektronik “e-Inspektimi”, në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut e cila shërben si bazë për programimin e veprimtarisë inspektuese si dhe në përputhje me metodologjinë e përgjithshme të inspektimit që përfshin: autorizimin e inspektimit dhe zhvillimin e procedurës së inspektimit online, deri në marrjen e vendimit përfundimtar, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, të skanuar në format origjinal, si dhe çdo dokument tjetër i nevojshëm. Kjo procedurë zhvillohet sipas afateve dhe rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin, si në versionin web ashtu edhe në versionin mobile të sistemit.

5. Procedura inspektuese, kryhet offline, në rastet kur nuk ka mbulim me rrjet apo internet, si pasojë e së cilës nuk mundësohet aksesimi në sistemin “e-Inspektimi”, me detyrimin që të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni përkatës, të sinkronizohet në sistem, sapo të rikthehet aksesueshmëria.

6. Inspektorati i Përgjithshëm përdor sistemin “e-Inspektimi” për:

- a) realizimin e veprimtarisë inspektuese mbi bazë risku dhe dokumentimin e saj;
- b) evidentimin e procesit të rekrutimit, zhvillimin e karrierës dhe ndjekjen e ecurisë së procedurave disiplinore të inspektorëve;
- c) organizimin dhe ndjekjen e trajnimit dhe testimit të inspektorëve;
- d) shqyrtimin e ankimeve administrative që lidhen me procesin e inspektimit;

- e) kërkimin dhe administrimin e informacionit në lidhje me procedurat inspektuese, përfshirë inspektimin e dokumentacionit përkatës;
- f) mbikëqyrjen online dhe në terren të procedurave inspektuese nga Inspektorati i Përgjithshëm;
- g) shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve.
7. Njoftimi i dokumentacionit të veprimtarisë inspektuese, bëhet nëpërmjet platformës “e-Albania”.
8. Çdo informacion për publikun, lidhur me veprimtarinë, funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Inspektoratit të Përgjithshëm, inspektorateve, si dhe në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të inspektimit sipas legjislacionit në fuqi, duhet të publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm.
9. Sistemi mundëson qasjen e përdorimit, nëpërmjet moduleve të veçanta, nga organe të tjera publike me funksione inspektimi të përjashtuara nga fusha e veprimit e ligjit për inspektimin.
10. Informacioni, që mblidhet nga organet e tjera me funksione inspektimi të përjashtuara nga fusha e veprimit të ligjit për inspektimin, përdoret për qëllime statistikore, studimore dhe për hartimin e politikave e të raporteve në fushën e inspektimit.
11. Inspektoratet kanë të drejtë të paraqesin pranë Inspektoratit të Përgjithshëm kërkesa për përmirësime, ndryshime dhe zhvillime në sistemin unik elektronik “e-Inspektimi”, në funksion të përmirësimit të efektivitetit të veprimtarisë së tyre inspektuese.
12. Të gjithë përdoruesit e sistemit “e-Inspektimi”, kanë detyrimin:
- a) të kujdesen për ruajtjen e konfidencialitetit të privilegjeve të aksesit në sistem, si dhe mbajnë përgjegjësi personale të drejtpërdrejtë në rast të shkeljes së rregullave, pakujdesisë apo keqpërdorimit të nivelit të tyre të aksesit;
- b) të kujdesen për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- c) të përdorin sistemin për realizimin e detyrave të tyre.
- d) “Përdoruesit e sistemit firmosin deklaratën e konfidencialitetit për përdorimin e të dhënave të sistemit e-inspektimi”
13. Përgjegjësit për dhënien e informacionit në sistemin e-inspektimi janë:
- a) Inspektorati i Përgjithshëm,
- b) Inspektoratet qendrore,
- c) Inspektoratet vendore,
- d) Strukturat përgjegjëse për inspektimin,
- e) Ministria e linjës,
- f) Njësia e qeverisjes vendore.
14. Niveli i aksesimit në sistemin elektronik “e-Inspektimi” është, si më poshtë vijon:
- a) Inspektorati i Përgjithshëm ka akses: administrator, mbikëqyrës, përdorues, lexues, prodhues i statistikave.
- b) ministria e linjës/njësia e qeverisjes vendore ka akses: mbikëqyrës, përdorues; lexues; prodhues i statistikave.
- c) Inspektorati qendror, vendor dhe struktura përgjegjëse për inspektimin ka akses: përdorues, lexues, prodhues i statistikave.

d) Bordi i inspektimit ka akses lexues.

Niveli i aksesimit, funksionet e të drejtat për secilin grup përdoruesi, në sistem, janë në përputhje me detyrat funksionale.

15. Inspektori i Përgjithshëm miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm, të bazës së të dhënave shtetërore, që krijohet nëpërmjet këtij vendimi.

16. Inspektori i Përgjithshëm, miraton element të tjerë shtesë në hapësirat e Sistemit, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të Inspektoratit të Përgjithshëm.

#### IV. TË DHËNAT PARËSORE, DYTËSORE, AKSESIMI DHE NDËRVERPIMI ME BAZAT E TJERA

1. Sistemi “e-Inspektimi”, si bazë unike të dhënash shtetërore, përmban të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, sipas moduleve, si më poshtë vijon:

2. Të dhëna parësore që reflektohen në sistemin “e-Inspektimi” janë:

a) të dhënat e inspektorateve”

- Emër Inspektorati;
- Ministria nga varet/njësia vendore;
- Adresa e Inspektoratit;
- Rajonet e Inspektoratit;

b) të dhënat e inspektorit (në të gjitha pozicionet);

i. *Të dhënat e përgjithshme*

- Diploma
- Data emërimit;
- Koha e provës;
- Vitet totale të eksperiencës së punës;
- Vitet totale të eksperiencës se punës si inspektor;
- Pjesëmarrja në Trajnime;
- Gjuhe te huaja;
- Kualifikime;
- Eksperienca të mëparshme pune;
- Testime;
- Foto.
- Përfundimi i marrëdhënieve të punës;

ii. *Të dhënat lidhur me Inspektoratin*

- Inspektorati ID;
- Fusha e inspektimit;
- ID e Rolit;

iii. *Lejet për inspektor*

- Data Fillimit;
- Data Mbarimit;
- Tipi i lejes.

iv. *Karta e Inspektorit*

- Data e lëshimit;
- Data e skadimit;
- Printimi Kartës.

v. *Performanca nga eprori*

- Rezultatet e vlerësimit të përgjithshëm profesional;
- Data e fillimit të vlerësimit të performancë;
- Data e mbarimit të vlerësimit të performancë.

vii. *Të dhënat lidhur me certifikimin*

- Titulli;
- ID e Inspektorit;
- Data e testimit;
- Rezultati;
- Data e ritestimit;
- Data e fillimit të certifikatës;
- ID certifikate.
- Dizenim dhe printim certifikate

viii. *të dhënat mbi masat disiplinore;*

- lloji masës disiplinore;
- numri vendimit;
- data;
- afati i vlefshmërisë.
- ankimimi në gjykatë.

viii. *Performanca nga Inspektorati i Përgjithshëm;*

c) të dhënat e programimit vjetor të inspektimit dhe programit vjetor të monitorimit;

- titulli i programit;
- viti;
- inspektorati / Rajoni;
- komente inspektorati;
- treguesit e programit vjetor.

d) të dhënat e programimit mujor të inspektimit;

- inspektorati;
- treguesit e programit mujor,
- përzgjedhja e planit mujor;
- përzgjedhja e Inspektor i/e Parë;
- përzgjedhja e Inspektor i/e Dytë;
- përzgjedhja e Inspektor i/e Tretë;
- fusha e inspektimit;
- aktiviteti;
- Inspektim i përbashkët;
- është inspektim i parë;
- Është inspektim për korrigjim detyrash të lëna;

- Data e inspektimit për korrigjim detyrave të lëna;
  - Komete;
- e) të dhënat për riskun;
- Faktorët e riskut që lidhen me subjektin e inspektimit;
  - Faktorët e riskut që lidhen me specifikat e sektorit të inspektimit;
  - Faktorët e riskut të shkeljeve ligjore të konstatuara;
  - Faktorët e riskut të efektit të papërputhshmërisë së kërkesave ligjore;
  - Faktorët e riskut që matin probabilitetin e ndodhjes së papërputhshmëri (historiku i subjektit);
  - Faktorët e riskut të përgjithshëm;
  - Faktorët e riskut ndërinstitucional.
- f) të dhënat e shkeljeve dhe dënimeve administrative;
- i. *Legjislacioni;*
- ii. *Shkeljet*
- Përshkrimi/Citimi i shkeljes;
  - Ligji të cilit i referohet;
  - Neni/pika/nëndarja/shkronja e ligjit ku zbatohet shkelja.
- iii. *dënimi administrativ*
- Përshkrimi/Citimi i dënimit administrativ;
  - Ligji të cilit i referohet dënimit administrativ;
  - Neni/pika/nëndarja/shkronja e ligjit që parashikon dënimin administrativ;
  - Kufiri më i ulët i dënimit administrative;
  - Kufiri më i lartë i dënimit administrative;
  - Matrica e dënimeve administrative.
- g) të dhënat e subjekteve dhe objekteve të inspektimit;
- h) të dhënat e çështjes së inspektimit;
- i. *Autorizimi*
- Kohëzgjatja e inspektimit;
  - Tipi i autorizimit;
  - Persona të tjerë të autorizuar
  - Objekti i inspektimit
  - Përzgjedhja listën e verifikimit;
  - Vendi ku do të kryhet inspektimi
  - Autorizim për ndryshimin e inspektorëve;
  - Kërkesë për refuzim të autorizimit të inspektorit;
  - Kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
- ii. *Krijimi i çështjes së inspektimit*
- Krijë çështje jashtë programit;
  - Çështjet e pa autorizuar;
  - Shtyrje autorizimesh;
  - Çështjet e refuzuara;

- Çështjet e anuluar;
- Lista e verifikimit;
- Procesverbal Inspektimi;
- Shënime;
- Vendim i ndërmjetëm;
- Vendim përfundimtar;
- Vendim për zgjidhjen e ankimit të veçantë;
- Vendim për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
- Vendimi i komisionit të ankimit;
- Dokumentet e skanuara;

j. Të dhënat mbi inspektimin në terren

- Autorizim
- Pyetësor/liste verifikimi
- Raport Paraprak i Mbikëqyrjes
- Raport Përfundimtar i Mbikëqyrjes

k. të dhënat mbi navigim / kërkim / raportim.

- Numër çështjeje;
- Inspektorati Shtetëror;
- Rajoni i Inspektoratit;
- Emër inspektori;
- Statusi çështjes;
- Periudha kohore.
- Chat box

3. Të dhënat dytësore, të sistemit “e-Inspektimi”, të cilat administrohen nga një tjetër bazë të dhënash shtetërore, janë:

a) Regjistri tregtar i administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për marrjen e të dhënave mbi subjektet e regjistruara si:

- NIPT parësorë dhe sekondar, në të gjitha statuset;
- adresa;
- statusi;
- administratori;
- të dhënat e kontaktit;
- subjektet e rinj;
- fushat e aktivitetit të subjektit të identifikuar nëpërmjet NIPT;
- lista e plotë e kodeve NACE,
- lloji i licencës / lejes, institucioni i përfshirë në dhënien e saj, data e lëshimit dhe vlefshmëria e saj, dokumentin e gjeneruar të licencës / lejes,
- fushat e aktivitetit të subjektit të identifikuar nëpërmjet NIPT dhe kodet ekonomike.

- b) Sistemet elektronike të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve:
1. “e- filling” për marrjen e të dhënave mbi subjektet shtetërore dhe subjektet e krijuara me vendim gjykatë:
    - NIPT-i subjektit shtetëror ,
    - emrin e subjektit shtetëror,
    - adresën,
    - statusin,
    - titullarin,
    - të dhënat e kontaktit,
    - formulari i listë pagesave - Esig 25,
    - formulari i lëvizjeve të fundit që kanë hyrë apo kanë dalë nga një subjekt - Esig 27,
    - xhiro vjetore,
    - tatim fitimi,
    - rezultati neto fitim/humbje (Deklarata Vjetore për Tatimin mbi te Ardhurat Personale te Biznesit (person fizik) dhe Deklarata Vjetore e Tatimit mbi Fitimin Koorporativ).
  2. “CATS” për marrjen e të dhënave mbi:
    - të dhëna për statusin në organet tatimore për të punësuarit (pozicioni i punës së punonjësve).
- c) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, për marrjen e të dhënave të shtetasve shqiptarë dhe shtetasve të huaj, mbi:
- NID/ID,
  - emër,
  - mbiemri,
  - datëlindja,
  - gjinia,
  - adresa.
  - shtetësia.
- ç) QNOD, për dërgimin e të dhënave nga sistemi “e-Inspektimi”, si:
- numri i certifikatës së regjistrit detar;
  - emri i anijes;
  - numri IMO.
- d) Sistemi i Qendëruar i Mbledhjes së Gjobave (Regjistri për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave), për dërgimin e të dhënave nga sistemi “e-Inspektimi”, si:
- Institucioni (drejtoria rajonal);
  - Nr. vendimi përfundimtar (numër çështje);
  - Data e vendimit;
  - Subjekti;
  - Shkelja ligjore;
  - Dënimi administrativ gjobe (kryesore plotësues);
  - Vlera e gjobës;
  - Statusi i gjobës.

Sistemi merr të dhëna nga platforma e pagesave elektronike mbi pagesën e gjobës.

dh) Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik, për shkëmbimin e statusit të aplikimit.

e) Sistemin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) LIMS, për dërgimin e të dhënave mbi:

1. Formular shoqërimi për kampionët e diagnozës së shëndetit të kafshëve
  - Administrative (Data ora e kampionimit; kampioni zyrtar; kampion nga njësia blegtorale; tjetër; Qarku; RUDA; Subjekti; Subjekti që ka kërkuar provën; Kampionuesi; Mënyra e kampionimit; Qëllimi i kampionimit; Veterineri Zyrtar; Ardhur me fetë shoqërimi)
  - Të dhëna mbi fermën ( Kodi i fermës; Fermeri- emër, mbiemër, atësia; Vendndodhja – rrethi, komuna fshati; Numri i kafshëve -të imta, gjedh, njëthundrak, derra, shpendë, bletë)
  - Anamneza/Arsyet e marrjes së kampionit (Vaksinime; Hyrje kafshë të te reja në fermë; Mjekimet; Gjurmime; Parashkruaj anamnezën)
2. Formular shoqërimi e sigurisë ushqimore
  - Administrative (Numri i fletës së shoqërimit, Data o pranimit ISUV, Qarku, Dorëzuesi, Pranoi ZPK, Subjekti kërkues)
  - Kampionimi ( Motivi i kampionimit, Metoda e kampionimit, Kampioni i kryer nga; Vendi i kampionimit, Pika a kampionimit, Data e kampionimit, Ent/Person fizik; Ferme)
  - Subjekti që i nënshtrohet provës (Enti/Personi Fizik, Prodhuesi, Furnizuesi, Shpërndarësi, Importuesi)
  - Kampioni (Kategori matric, Matrica, Emërtimi i Produktit, Origjina e mostrës, Paketimi, Njësi mostre, Sasi për njësi, Njësia e matjes, Temperatura e mbërritjes, Data e skadimit, Kushtet e ruajtjes, Temperatura e ruajtjes, Kushtet e transportit, Medikamentet ose preparatet e përdorura katër javët e fundit para marrjes së mostrës, Përshkrime të tjera, Loti, Lloji i kafshës, Moshë, Matrikulli)
  - Provat

Gjithashtu, sistemi “e-Inspektimi” do të marrë nga LIMS të dhëna për rezultatin e provës së kampionit.

ë) Sistemi i Sistemin e Integruar Mjedisor, ku sistemi do dërgojë të dhëna që lidhen me:

- numrin e çështjes,
- të dhënat e subjektit,
- data e hapjes së çështjes,
- data e mbylljes së çështjes,
- programuar
- jashtë programi
- ri inspektim,
- tipi inspektimit,
- statusi i çështjes,

Ndërsa Sistemi e Integruar Mjedisor do dërgojë të dhëna në sistemi “e-Inspektimi” për dokumentacionin që gjeneron ky sistem:

- leje mjedisore, numër, datë lëshimi, afati i lejes,
- raport vet monitorimi.

f) Sistemin e Qendrës së Botimeve Zyrtare, për marrjen e të dhënave mbi:

- titulli;
- numri;
- viti;
- kërko sipas kalendarit;
- lloji i aktit;
- institucioni përgjegjës;
- institucioni propozues;
- fusha e veprimtarisë.

g) Sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) për tërheqjen e të dhënave si:

- të dhënat e eksport-impORTEVE të kryer nga operatorët ekonomikë dhe individët;
- deklarata doganore për të dhënat me interes për procesin e inspektimit;
- lista e mallrave/produkteve me kodin doganor përkatës;
- lista të miratuara nga duhet të importohen mallra të caktuar;
- kodet e mallrave të akcizës (duhan cigares e pijeve alkoolike);
- deklaratat që shoqërojnë ngarkesat (deklarata e konformitetit, marketimi CE, raport testet, fletë garancie, fito sanitare, vendi i prodhimit, vendi i origjinës, fatura (invoice).

gj) Sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (FER) për shtetasit e huaj që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët do të kryejnë aktivitet të përkohshëm dhe nuk rezultojnë të regjistruar në Regjistrin e Gjendjes Civile , si:

- ID
- Emër;
- mbiemër;
- datëlindja;
- gjinia;
- adresa;
- shtetësia.

h) Sistemin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), ku sistemi duhet të marrë të dhëna përsa i përket:

- Sistemi i Adresave;
- Ortoimazheria;
- Parcelat kadastrale;
- Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare;
- Hidrografia;
- Përdorimi i tokës;
- Burimet energjetike;
- Zonat e mbrojtura.

i) Ndërveprimi me sistemin e menaxhimit të çështjeve në gjykata, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku sistemi do tërheqë të dhëna përsa i përket:

- Numri i çështjes;
- Numri i aktit;
- Data e regjistrimit;
- Regjistri;
- Tipi i çështjes;
- Emri i gjyqtarit;
- Statusit i çështjes;
- Objekti i padisë;
- Baza ligjore;
- Palët;
- Vendimet
- Numri i vendimit;
- Data e vendimit
- Mënyra e përfundimit,
- Vendimi përfundimtarë;
- Vendime të mëparshme;
- Seanca gjyqësore.

## V. INFORMIMI DHE RIPRODHIMI I PËRMBAJTJES SË SISTEMIT (SIGURIMI I BAZËS SË TE DHËNAVE)

1. Të dhënat dhe programet, si dhe informacioni i ruajtur ose informacioni, i cili duhet të ruhet, riprodhohen, kopjohen ose shumëfishohen vetëm për qëllimet e parashikuara në këtë vendim, si dhe për sa është parashikuar në legjislacionin në fuqi.
2. Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet, si dhe ministritë përgjegjëse, përpunojnë e publikojnë informacionin dhe të dhënat e mbajtura në sistem për qëllime kërkimore, statistikore, në shërbim të përmirësimit të veprimtarisë së inspektimit dhe informimit të publikut, sipas legjislacionit në fuqi për informimin e publikut dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Personat e jashtëm kanë vetëm të drejtën e informimit për të dhënat e publikuara në faqen e internetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për informimin e publikut dhe me këtë vendim.
4. Të drejtën për t'u njohur me informacionin që raportohet në sistem e kanë edhe subjekte që burojnë nga marrëveshje me institucione partnere, sipas procedurave të parashikuara me akte nënligjore të veçanta.
5. Subjektet e interesuara në regjistrin e të dhënave të sistemit, janë: Qytetarët, Biznesi, Institucionet Publike. Aksesit për palët e interesuara është vetëm lexim, si dhe jep mundësinë e raportimit të ankesave online.

## VI. MBIKËQYRJA ONLINE DHE NË TERREN, E VEPRIMTARISË INSPEKTUESE

1. Inspektorati i Përgjithshëm është përgjegjës për mbikëqyrjen e inspektorateve, për zbatimin e legjislacionit në fuqi për inspektimin, duke përfshirë edhe legjislacionin e posaçëm, sipas fushës së

inspektimit, si dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre.

2. Inspektorati i Përgjithshëm ka të drejtë të inspektojë dosjet e inspektimit të realizuara nga inspektoratet, në sistem dhe në terren, e cila përmban tërësinë e dokumenteve dhe të dhënave elektronike të krijuara, të ngarkuara ose të përpunuara gjatë një inspektimi.

3. Inspektorati i Përgjithshëm ushtron mbikëqyrje periodike dhe sipas rastit mbi dosjet e inspektimit, të gjeneruara në sistemin e-Inspektimi, përmes modulit të dedikuar në sistem.

4. Mbikëqyrja online e veprimtarisë inspektuese bëhet:

a) Periodikisht, sipas programeve të mbikëqyrjes dhe monitorimit;

b) Me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, në rast sinjalizimesh, dyshimesh, denoncimesh apo ankimi.

5. Objekt i mbikëqyrjes së Inspektoratit të Përgjithshëm janë respektimi i procedurave për:

a) programimin e inspektimit;

b) autorizimin e inspektimit;

c) kryerjen e procedurës së inspektimit.

6. Inspektorati i Përgjithshëm për inspektimin e dosjeve të inspektimit, ka të drejtë t'iu kërkojë inspektorateve, të gjithë informacionin e nevojshëm, dhe këta të fundit janë të detyruar t'i përgjigjen, sipas kërkesës së Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga kërkesa e bërë.

7. Inspektorati i Përgjithshëm, në përfundim të inspektimit të dosjeve, dërgon raportin paraprak të mbikëqyrjes pranë inspektoratit, dhe kryeinspektori, inspektori, si dhe çdo zyrtar tjetër i prekur nga gjetjet e raportit paraprak të mbikëqyrjes, kanë të drejtë të japin shpjegimet e tyre brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

8. Inspektorati i Përgjithshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga marrja e observacioneve dhe shpjegimeve, pasi i ka shqyrtuar ato, miraton raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

9. Inspektori i Përgjithshëm urdhëron mbikëqyrjen e procedurës së inspektimit në terren, në rastet kur:

a) subjekti paraqet nivel të lartë risku, është objekt inspektimi nga disa inspektorate ose inspektohet për herë të parë;

b) ekzistojnë dyshime të arsyeshme ose denoncime për moskryerjen me objektivitet të procedurës inspektuese nga trupa inspektuese;

c) procedura inspektuese paraqet kompleksitet për shkak të specifikave të fushës së inspektimit, madhësisë, shtrirjes së aktivitetit, në raport me zbatimin e kërkesave ligjore;

d) zbatohet një qasje ose metodologji e re në procedurën inspektuese, e iniciuar nga Inspektori i Përgjithshëm;

dh) kërkohet vlerësimi i zbatimit të njëtrajtshëm të procedurave inspektuese nga trupat inspektuese, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe standardet e miratuara;

e) synohet monitorimi i performancës së trupave inspektuese dhe evidentimi i nevojave për përmirësim të kapaciteteve profesionale dhe unifikimin e praktikave;

ë) zhvillohen fushata sensibilizuese dhe informuese ndaj subjekteve të inspektimit, me qëllim garantimin e informimit për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi;

f) kërkohet verifikimi i respektimit të standardeve të komunikimit, etikës dhe transparencës së trupës inspektuese gjatë ndërveprimit me subjektet e inspektimit.

10. Inspektorët e mbikëqyrjes në terren, pranë Inspektoratit të Përgjithshëm kanë të drejtë të hyjnë në subjektin që inspektohet, dhe të kryejnë veprime mbikëqyrëse në terren, gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese nga trupa inspektuese, por pa ndërhyrë në vendimmarrjen e trupës inspektuese.

11. Inspektorët e Inspektoratit të Përgjithshëm, hartojnë raportin e mbikëqyrjes në terren, së realizimit të procedurës së inspektimit në terren dhe ja paraqesin Inspektorit të Përgjithshëm.

12. Kur e gjykon të arsyeshme dhe ka dyshime për mosrealizimin e veprimtarisë inspektuese, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, Inspektori i Përgjithshëm urdhëron realizimin e mbikëqyrjes pranë ambienteve të inspektorateve.

## VII. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË INSPEKTUESE

1. Inspektorati i Përgjithshëm është përgjegjës për raportimin e veprimtarisë inspektuese të inspektorateve.

2. Inspektorati i Përgjithshëm raporton përpara bordit të inspektimeve për çështjet që janë në funksion të këtij të fundit.

3. Inspektorati i Përgjithshëm përgatit raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve, për inspektoratet dhe ky raport i paraqitet ministrit përgjegjës për ekonominë, dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, brenda datës 20 mars të vitit pasardhës.

4. Inspektoratet dërgojnë pranë Inspektoratit të Përgjithshëm raportin vjetor të veprimtarisë inspektuese, brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës.

5. Sistemi gjeneron raporte periodike në nivel inspektorati të Përgjithshëm, inspektorati, drejtorie rajonale dhe në nivel aksesi që ka çdo përdorues.

## VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohen ministritë e linjës, Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore, dhe strukturat përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin e këtij vendimi.

2. VKM nr. 696, datë 16.08.2013, "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi", shfuqizohet.

3. Kërkesat dhe procedurat administrative që preken nga ky vendim zbatohen pas përmirësimit të sistemit "e-Inspektimi".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**